



British Embassy  
Pristina



---

# TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2019

MARS 2020, PRISHTINË





# **TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2019**

MARS 2020, PRISHTINË

# PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTËR .....	6
HYRJE .....	7
METODOLOGJIA .....	8
LISTA E INDIKATORËVE:.....	8
MATJA DHE METODAT E HULUMTIMIT .....	15
TË GJETURAT KRYESORE .....	18
Transparenca në punën dhe vendimet e Kuvendit të Komunës .....	18
Pjesëmarrja qytetarëve në takime publike e dëgjime buxhetore .....	21
Mbikëqyrja e Drejtorive nga Kuvendet e Komunës .....	26
Konsolidimi i Këshillave të Fshatrave/Bashkësive Lokale .....	26
Transparenca dhe llogaridhënia e Drejtorive Komunale .....	28
Rregullorja për ngacmime seksuale .....	29
Emërtimet adekuate të dokumenteve publike ne uebfaqet e Komunave .....	29
Përdorimi i gjuhëve zyrtare .....	29
REKOMANDIMET .....	32

COPYRIGHT © 2020. KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materiale që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

AUTOR: KDI, NGO AKTIV

Layout and design: **envinion**

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale" realizohet me fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës KDI /NGO AKTIV dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar



# LISTA E SHKURTËR

## KAB

Korniza Afatmesme Buxhetore

## KPF

Komiteti për Politikë dhe Financa

## KK

Kuvendi Komunal

## MAPL

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

## MAP

Ministria e Administratës Publike

## UA

Udhëzimet Adiministrative

## ZIE

Zyra për Integritime Evropiane



# HYRJA

Transparenca dhe llogaridhënia e insitucioneve publike, janë një nga parakushtet kyçe, për konsolidimin e një shteti demokratik. Transparenca e institucioneve publike, ndikon drejtpërdrejt në funksionimin e mirëfilltë të institucioneve publike dhe rrjedhimisht përmirëson jetën e qytetarëve. Për më shumë, transparenca institucionale rritë bashkëpunimin mes qytetarëve dhe institucioneve publike, dhe mundëson pjesëmarrjen më të madhe të grupeve të marginalizuara në vendimmarrje. Kështu, njëkohësisht siguron që të ndërtohen politika më të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Insitucionet lokale shërbejnë si mekanizma kryesore, ku qytetarët adresojnë kërkesat dhe ankesat e tyre, për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet komuniteti.<sup>1</sup> Rrjedhimisht, transparenca dhe llogaridhënia duhet të jenë prioritet i institucioneve lokale gjatë hartimit të agjendës së tyre, e cila do të mundëson përmirësimin e performancës së tyre në qeverisje dhe përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të marginalizuara në procesin e vendimmarrjes.

Për më tepër, transparenca u mundëson qytetarëve që të kenë qasje në informacionet që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale, e cila shërben si mekanizëm për luftimin e dukurive negative, që mund të dëmtojnë jetën e përditshme të tyre. Qasja në informacione publike kështu, është mjet që i shërben luftës kundër korrupsionit dhe uljes së nivelit të keqpërdorimeve me mjete publike.

Viteve të fundit Komunitat në Kosovë, kanë shënuar rritje në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies, duke mundësuar kështu, që qytetarët të kenë qasje në informata publike dhe të jenë pjesë e politik-bërjes në nivelin Komunal.

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës, garanton transparencën e institucioneve karshi qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisja lokale, ligji për qasje në dokumente publike, e udhëzime të tjera administrative legjitimojnë këtë garancion, si dhe sigurojnë qytetarët që nëpërmjet mjeteve të nevojshme ligjore të kërkojnë transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë.

Duke u bazuar në rëndësinë e transparencës dhe bazën ekzistuese ligjore, KDI-ja ka zhvilluar matjen e transparencës në 38 Komuna. Kjo matje është zhvilluar në një periudhë të caktuar kohore dhe ka për qëllim pasqyrimin e rezultateve të Komunave, si hap i parë drejt ngritjes së mëtejshme të nivelit të transparencës.

KDI-ja shpreson që rezultatet e Transparometrit, do të shërbejnë si udhërrëfyes dhe motivim për ngritjen e transparencës së institucioneve lokale karshi qytetarëve, avancimin e proceseve vendimmarrëse përmes bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes qytetare. Mbi të gjitha, përmirësimin e shërbimeve për qytetarët e Komunave përkatëse.

<sup>1</sup> KDI, "Transparometrikomunal", 2017. [http://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2018/02/Transparometri-ALB-ALL-SMALL\\_Fin.pdf](http://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2018/02/Transparometri-ALB-ALL-SMALL_Fin.pdf)



# METODOLOGJIA

Ky hulumtim është realizuar në të gjitha Komunitet e Republikës së Kosovës, 38 sish. Performanca e institucioneve Komunale është vlerësuar në bazë të 48 indikatorëve, të

hartuar sipas modeleve dhe paraprake të Transparometrit,<sup>2</sup> bazuar në metodologjinë e Transparency International dhe në përvojën shumëvjeçare të KDI-së.

## LISTA E INDIKATORËVE:


- 1 A janë publikuar njoftimet për seancat e Kuvendit të Komunës dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së seancave?
- 2 A i është bashkëngjitur njoftimeve për seanca të Kuvendit të Komunës materiali përcjellës?
- 3 A është bërë informimi i publikut për seancat e Kuvendit të Komunës në vendet më të frekuentuara nga qytetarët, përmes mediave dhe rrjeteve sociale?
- 4 A janë publikuar njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve?
- 5 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës 10 seanca të rregullta gjatë vitit, siç parashihet me ligj?
- 6 A janë mbledhjet e Komiteteve të përhershme të hapura për publikun?
- 7 A janë të publikuara në webfaqen e Komunës të dhënat për të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (emri, mbiemri, data e lindjes, emaili, adresa e banimit, numri i telefonit, subjekti politik)?
- 8 A mund të gjendet në webfaqen zyrtare të komunës një historik i shkurtër për Komunën?
- 9 A e ka të publikuar në webfaqe Kuvendi i Komunës planin e tij të punës?
- 10 A ka Kuvendi i Komunës një plan të veprimit për transparencë dhe a është i njejtë publik?
- 11 A janë të publikuara video-linqet e seancave të Kuvendit të Komunës pas mbajtjes së tyre?
- 12 A ka publiku qasje në draft rregulloret e Kuvendit të Komunës?
- 13 A janë publike rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës?
- 14 A publikohen provesverbalet e seancave të Kuvendit të Komunës dhe rezultatet e votimit mbi pikat e rendit të ditës?
- 15 A ka qasje publiku në vendimet e Kuvendit të Komunës?
- 16 A janë seancat e Kuvendit të Komunës të hapura për publikun?
- 17 A transmetohen seancat e Kuvendit të Komunës drejtpërdrejtë, dhe nëse po, përmes çfarë platformave?

<sup>2</sup>TransparometriKomunal 2018, KDI <http://kdi-kosova.org/publikimet/transparometri-komunal-2018-2/>

TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2019

- 18 A e kanë thirrur në raportim, kryetarin e Komunës, Kuvendi i Komunës ose Komitetet ?
- 19 A i kanë thirrur në raportim, drejtorë e Drejtorive, Kuvendi i Komunës ose Komitetet ?
- 20 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës, diskutime mbi shpenzimet tremujore brenda afateve ligjore?
- 21 A janë të gjitha dokumentet publike, të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 22 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës, diskutime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)?
- 23 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës, gjatë muajit shtator, diskutime publike për buxhetin vjetor për 2020?
- 24 A është bërë konsolidimi i Bashkësive Lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?
- 25 A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografia e kryetarit/es në webfaqen zyrtare?
- 26 A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografitë e drejtorëve të Drejtorive Komunale në webfaqen zyrtare?
- 27 A ka në webfaqe informacione lidhur me çështjet e integritetit në BE dhe ndikimin që ato kanë në qeverisjen Komunale?
- 28 A publikohen konkurset e punësimeve, përfshirë kriteret?
- 29 A disponon Komuna me koordinator përgjegjës për qasje në dokumente zyrtare ?
- 30 A disponon Komuna me një mekanizëm përcjellës për regjistrimin dhe statusin e kërkesave të qytetarëve
- 31 A ofron Komuna qasje të papenguar në dokumente zyrtare?
- 32 A është publik plani vjetor i kryetarit/es të Komunës?
- 33 A është webfaqja zyrtare e Komunës e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 34 A janë të gjitha vendimet e kryetarit/es të Komunës të qasshme për publikun?
- 35 A është bërë publik borxhi Komunal?
- 36 A është publikuar lista e pronave Komunale të dhëna me qira ose në shfrytëzim?
- 37 A janë publikuar të dhënat për të hyrat vetanake të Komunës?
- 38 A janë të qasshme të dhënat e Komunës në formatin e Open data (verzione të shfrytëzueshme dhe të përpunueshme)?
- 39 A shfrytëzon Komuna rrjetet sociale për të komunikuar dhe plasuar informata për qytetarët?
- 40 A janë publike kontaktet e zyrtarit/es për informim?
- 41 A ka Komuna në dispozicion një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët?
- 42 A disponon/publikon Komuna me një listë mbi shërbimet që ajo i ofron për qytetarët?
- 43 A disponon/publikon Komuna materialin paraprak për dëgjimet buxhetore dhe takimet publike?
- 44 A ka organizuar Komuna takimet publike të parapara me ligj?
- 45 A publikon Komuna aktivitetet e saj në webfaqe?
- 46 A kanë organizuar Drejtoritë e Komunës dëgjime buxhetore për buxhetin vjetor 2020 sipas afateve ligjore?
- 47 A disponon/publikon Komuna procesverbale nga dëgjimet buxhetore?
- 48 A është publikuar në webfaqe buxheti Komunal për vitin 2020?






## LIDHUR ME SECILIN INDIKATOR

Komunat janë poentuar me **0 deri në 2 pikë**, varësisht nga niveli i informacionit që ato kanë ofruar apo kanë qenë të qasshme. Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion lidhur me një indikator të caktuar janë poentuar me **0 pikë**. Kur informacioni ka qenë i pjesshëm, Komunat janë poentuar me **1 pikë**, ndërsa kur informacioni ka qenë i plotë, Komunat janë poentuar me **2 pikë**.

Rezultati maksimal për një Komunë për të gjithë indikatorët është → **96 PIKË**

Rezultati minimal për një Komunë për të gjithë indikatorët është → **0 PIKË**



## Korniza ligjore e cila është konsultuar gjatë përcaktimit të indikatorëve

- Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
- Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike
- Ligji Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve
- Udhëzimi Administrativ (MAPL) NR. 04/2018 Për Transparencë në Komuna
- Udhëzimin Administrativ të MAP nr. 01/2015 për Webfaqet e institucioneve publike
- Vendimin e Qeverisë 07/87 mbi miratimin e Kartës për Hapjen e të Dhënave
- Rregulloren (QRK) nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës



# MATJA DHE METODAT E HULUMTIMIT

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka kryer hulumtimin në 34 Komuna<sup>3</sup> përderisa OJQ AKTIV ka kryer hulumtimin në 4 komuna: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok.

Hulumtimi në 34 Komuna, ku KDI-ja, ka bërë matjet është zhvilluar gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2019, ndërsa hulumtimi në 4 Komuna me shumicë serbe është realizuar gjatë tre muajve nëntor-dhjetor 2019 dhe janar 2020.

Më 22 nëntor, KDI-ja dhe OJQ AKTIV përmes adresës elektronike i kanë dërguar letra informuese të gjitha Komunave, përmes të cilave i kanë njoftuar ato për metodologjinë e Transparometrit, përfshirë indikatorët dhe poentimin.

Vlerësimi i përmbushjes së indikatorëve për 34 Komuna, ku KDI-ja ka kryer hulumtimin është bërë në bazë të të dhënave nga burimet e mëposhtme:

- Web faqet zyrtare të Komunave të administruara nga Ministria e Administratës Publike
- Përgjigjet e autoriteteve lokale në kërkesat e bëra në bazë të ligjit për qasje në dokumente dhe informata publike
- Intervistat me autoritetet e qeverisjes lokale
- Monitorimi i punës së autoriteteve Komunale

Ndërsa për shkak të kontekstit politik, që ka prekur kryesisht katër Komuna me shumicë serbe, në Veri të Kosovës, vlerësimi i indikatorëve nga OJQ AKTIV për këto Komuna është bazuar në burimet e mëposhtme:

- Web faqet zyrtare të Komunave të administruara nga Ministria e Administratës Publike.
- Webfaqet: <https://www.ezubinpotok.com/>; <http://www.ezvecan.com/>; <https://www.eleposavic.com/> dhe <http://www.eevernamitrovica.com/>, të administruara nga OJQ New Social Initiative (<http://newsocialinitiative.org/>) me seli në Mitrovicën e Veriut;

<sup>3</sup> Me datën 11 dhjetor 2019, Komuna e Deçanit, përmes postës elektronike ka njoftuar KDI-në, që refuzon të përgjigjet në kërkesat drejtuar kësaj komune, për qasje në dokumente zyrtare. Kjo komunë gjithashtu ka refuzuar kërkesën e KDI-së për intervistë. Prandaj, vlerësimi për përmbushjen e indikatorëve për këtë komunë është bazuar vetëm në të dhënat që kanë qenë të qasshme në Web faqen zyrtare të Komunës.






Tabela numër 1. (Renditja e Komunave)

KOMUNA	PIKËT	PËRQINDJE
Rahovec	85	88.54
Mitrovicë e Jugut	83	86.46
Prishtinë	83	86.46
Drenas	80	83.33
Malishevë	80	83.33
Viti	80	83.33
Gjakovë	78	81.25
Pejë	78	81.25
Suharekë	78	81.25
Vushtrri	78	81.25
Lipjan	77	80.21
Prizren	77	80.21
Gjilan	76	79.17
Kaçanik	75	78.13
Ferizaj	74	77.08
Shtime	73	76.04
Kamenicë	72	75.00

Klinë	72	75.00
Graçanicë	69	71.88
Hani i Elezit	69	71.88
Dragash	68	70.83
Podujevë	67	69.79
Istog	66	68.75
Skenderaj	66	68.75
Obiliq	66	68.75
Novobërdë	58	60.42
Klllokot	56	58.33
Leposaviq	56	58.33
Zveçan	55	57.29
Mamushë	53	55.21
Shtërpce	53	55.21
Partesh	52	54.17
Ranillug	52	54.17
Deçan	50	52.08
Zubin Potok	46	47.92
Fushë Kosovë	45	46.88
Junik	44	45.83
Mitrovicë e Veriut	39	40.63





|||||

Istog	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht	Jo
Obiliqi	Po	Jo	Pjesërisht	Jo
Lipjani	Po	Jo	Pjesërisht	Po
Shtime	Po	Jo	Po	Pjesërisht
Podujeva	Po	Jo	Po	Pjesërisht
Novobërda	Po	Po	Po	Jo
Ranillug	Po	Jo	Jo	Jo
Partesh	Po	Po	Po	Jo
Klllokot	Po	Jo	Po	Jo
Viti	Po	Po	Po	Pjesërisht
Fushë Kosova	Po	Jo	Po	Jo
Skenderaj	Pjesërisht	Jo	Pjesërisht	Po
Malisheva	Po	Jo	Po	Po
Prizren	Po	Jo	Po	Po
Mamusha	Po	Jo	Po	Jo
Klina	Po	Jo	Po	Pjesërisht
Peja	Pjesërisht	Jo	Po	Po
Decan	Po	Jo	Po	Jo
Junik	Pjesërisht	Jo	Jo	Jo
Kacanik	Po	Jo	Po	Po
Hani i Elezit	Po	Jo	Po	Jo

|||||

|||||

Në përgjithësi uebfaqet e Kuvendeve Komunale janë të qasshme për publikun. Në dhjetë Komuna, Kuvendet Komunale nuk e kanë të qasshme planin e tyre të punës, siç është Komuna e Ferizajt, Zubin Potokut, Leposaviçit, Mitrovicës së Veriut, Ranillug, Fushë Kosovës, Mamushës, Junikut dhe Novobërdës. Po ashtu në dhjetë Komuna, Kuvendet Komunale nuk kanë plan për transparencë dhe nuk është e publikuar (Komuna e Gjakovës, Zubin Potok, Mitrovica e Veriut, Kamenicë, Novoberdë, Viti, Fushë Kosovë dhe Junik).

Shumica e uebfaqeve të Komunave përmbajnë kontaktet e këshilltarëve Komunal, vetëm në uebfaqen e 7 Komunave nuk janë të publikuara të dhënat për këshilltarët Komunal.

Gati të gjitha Komunat praktikojnë transmetimin direkt të seancave të Kuvendit të Komunës përmes medimeve të ndryshme si youtube, teleprezenca MAPL, rrjeteve sociale (Facebook), televizionet lokale.

Mirëpo, në 17 Komuna, Kuvendet Komunale, siç është Komuna e Graçanicës, Zubin Potok, Shterpce, Zecan, Mitrovica Veriore, Istog, Obiliqi, Podujeve, Novoberd, Ranilluk, Partesh, Fushe Kosove, Mamushe, Kline, Deçan, Junik, Hani i Elezit nuk kanë bërë publike video – linqet e seancave të Kuvendit Komunal pas mbajtjes së tyre. Ndërsa 6 Komuna nuk kanë të publikuar procesverbalin e seancave të Kuvendit të Komunës dhe rezultatet e votimit mbi pikat e rendit të ditës.

## Pjesëmarrja qytetare në takime publike e dëgjime buxhetore

Matja përfshinë çështjet që kanë të bëjnë me rritjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet publike dhe dëgjimet buxhetore, të kornizuara edhe sipas legjislacionit në fuqi dhe statuteve të Komunave të miratuara. Indikatorët e përdorur përfshijnë, numrin e takimeve publike, numrin e dëgjimeve buxhetore të organizuara nga Drejtoritë e Komunës edhe nga Kuvendi Komunal, materialet përcjellëse, proceverbale të miratuara etj. Verifikimi i të dhënave është bërë përmes kërkesës për qasje në dokumentet publike të

drejtuar Komunave, intervistave të realizuara me zyrtarët Komunal si dhe përmbajtja e lajmeve, procesverbaleve në faqet e Komunave.

Në 21 nga 38 Komuna, ku është bërë matja, Kuvendet e Komunës kanë mbajtur takime publike për KAB (shih tabelën numër 3). Ndërsa 18 nga 38 Kuvende të Komunave, kanë aprovuar buxhetet vjetore për 2020 pa organizuar paraprakisht dëgjime publike në muajin shtator, ashtu siç parashihet me ligjin për vetqeverisje lokale.

Komuna e Malishevës dhe Suharekës ka treguar një trend pozitiv, rreth mbajtjes së takimeve buxhetore. Kuvendi i Komunës së Malishevës ka organizuar mbi 30 takime buxhetore, ndërsa ai i komunës së Suharekës ka organizuar mbi 40 takime buxhetore me qytetarët.

|||||

Tabela numër 3. (Dëgjimet për KAB dhe buxhetin nga Kuvendet Komunale)

KUVENDET E KOMUNËS QË NUK KANË ORGANIZUAR ASNJË TAKIM PUBLIK PËR KAB 2020-2022	KUVENDET E KOMUNËS QË NUK KANË ORGANIZUAR ASNJË DËGJIM PUBLIK (GJATË SHTATORIT) PËR BUXHETIN E VITIT 2020
Dragash	Vushtrri
Gjakova	Ferizaj
Ferizaj	Rahovec
Graçanica	Mitrovicë e Jugut
Mitrovicë e Jugut	Shtërpca
Prishtina	Gjilan
Shtërpca	Kamenica
Gjilan	Drenas
Drenas	Obiliq
Istog	Podujeva
Obiliq	Viti
Lipjan	Fushë Kosova
Shtime	Skenderaj
Podujeva	Prizren
Fushë Kosova	Mamusha
Prizren	Peja
Mamusha	Junik
Deçan	Hani i Elezit
Junik	
Kaçanik	
Hani i Elezit	

Në takimet publike dhe dëgjimet buxhetore të organizuara nga Komunitatet e Kosovës,<sup>4</sup> në përgjithësi kanë marrë pjesë numër i vogël i qytetarëve. Ndërsa pjesëmarrja e grave dhe vajzave ka qenë edhe më e ulët. Gjatë organizimit të takimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore, 36 nga 38 Komuna kanë bërë përpjekje që t'ua shpërndajnë paraprakisht publikut materialet e takimit, në bazë të të cilave të interesuarit do të informoheshin për detajet e takimit dhe potencialisht do të stimulohej pjesëmarrja më e madhe të publikut në këto takime. Ndërsa, vetëm Komuna e Fushë Kosovës dhe Mamushës nuk kanë bërë fare shpërndarjen e këtyre materialeve.

Vetëm në komunën e Mamushës, Drejtoritë nuk kanë organizuar dëgjime buxhetore për buxhetin vjetor 2020 sipas afateve ligjore.



Në shtatë (7) Komunitat në vijim: Kamenicë, Novo Bërdë, Partesh, Kllokot, Mamushë, Kaçanik dhe Hani i Elezit, në të cilat Drejtoritë kanë organizuar dëgjime buxhetore për vitin 2020, procesverbalet nga këto takime nuk janë bërë publike. Mos publikimi i procesverbaleve të dëgjimeve buxhetore ka ndikuar negativisht që kërkesat dhe prioritetet e qytetarëve të mos jenë transparente gjatë këtij procesi.

Interesimi dhe pjesëmarrja e dobët e qytetarëve në konsultime publike mund të prodhojë politika dhe buxhete të cilat nuk reflektojnë në mënyrë të drejtë dhe transparente prioritetet e qytetarëve. Mbi të gjitha, mospërpjekja e mjaftueshme e autoriteteve Komunale për të gjetur mënyra më inovative përtej obligimeve ligjore, për ta sjellë qytetarin më afër vendim-marrjes dhe për ta mbajtur atë të sa më të informuar në vazhdimësi, nuk është në funksion të qeverisjes së mirë, transparente dhe llogaridhënëse.

Në 21 nga 38 Komuna, ku është bërë matja, Kuvendet e Komunës kanë mbajtur takime publike për KAB (shih tabelën numër 3). Ndërsa 18 nga 38 Kuvende të Komunave, kanë aprovuar buxhetet vjetore për 2020 pa organizuar paraprakisht dëgjime publike në muajin shtator, ashtu siç parashihet me ligjin për vetqeverisje lokale.

|||||

Tabela numër 4 (Organizimi i dëgjimeve buxhetore)<sup>5</sup>

	 DREJTORITË	 KUVENDI KOMUNAL
Prishtina	5	1(shtator)
Mitrovicë e Jugut	7	0
Vushtrri	3	14
Obiliq	8	0
Skenderaj	11	0
Fushë Kosova	3	0
Lipjan	8	1(shtator)
Shtime	8	0
Podujeva	3	0
Istog	1	1(shtator)
Peja	14 (Drejtoritë s bashku me KK)	
Klina	4	1
Drenas	6	0
Gjakova	12 (Drejtoritë s bashku me KK)	
Deçan	4( Drejtoritë sëbashku me KK)	
Junik	2	0
Viti	17	0

<sup>5</sup>Burimi i të dhënave është i bazuar në përgjegjet e zyrtarëve komunal në pyetjet drejtuara zyreve përinformim në 38 komunat e Kosovës.

|||||

|||||

Kamenica	21	0
Hani i Elezit	6	0
Mamusha	0	0
Prizren	5	0
Malisheva	12	35
Dragash	7	0
Suhareka	40	2
Rahovec	38	10
Ferizaj	12	0
Gjilan	7(Drejtoritë së bashku me KK)	
Kacanik	3(s bashku me KK)	
Gracanica	16 (s bashku me KK)	
Shtërpca	5(së bashku me KK)	1(shtator)
Klllokot	1	3
Ranillug	0	9
Novobërda	4	1
Partesh	0	3
Leposaviç	4	2
Mitrovicë e Veriut	3	3
Zveçan	3	1
Zubin Potok	4	2

|||||



## Mbikëqyrja e Drejtorive nga Kuvendet e Komunës

Funksioni mbikëqyrës i shumicës së 38 Kuvendeve të Komunës, ndaj Drejtorive Komunale, gjatë 2019-të, ishte i reduktuar kryesisht në dispozitat ligjore<sup>6</sup> që e obligojnë kryetarin e Komunës të raportojë në periudha 6 mujore para Kuvendit për zbatimin të planeve investuese dhe për situatën ekonomike e financiare të komunës. Përfundimisht bëjnë Kuvendet e Komunës së Suharekës, Zubin Potokut, Kamenicës dhe Malishevës, të cilat kanë ftuar Kryetarin e Komunës në raportime shtesë, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.<sup>7</sup> Ndërsa si praktikë e mirë Kuvendet e Komunave të Graçanicës, Rahovecit, Mitrovicës së Jugut, Zubin Potokut, Suharekës, Gjilanit, Vitisë, Malishevës dhe Klinës kanë thirrur në raportim edhe drejtorët e Drejtorive komunale.

Këshillat të fshatrave, brenda afateve kohore të parapara me ligj dhe në mënyrë transparente e lehtëson komunikimin e banorëve me autoritetet Komunale, mundëson përfaqësim dhe adresim më të mirë të kërkesave e prioriteteve dhe rritë besueshmërinë e qytetarëve në qeverisjen Komunale. Për më tepër, Këshillat e fshatrave shërbejnë si një urë lidhëse në mes të komunitetit dhe zyrtarëve Komunal, për të përmirësuar jetën e qytetarëve.

## Konsolidimi i Këshillave të Fshatrave/ Bashkësive Lokale

Sipas Ligji për vetëqeverisjen lokale, çdo Komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatra, vendbanime dhe lagje urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës, përderisa forma e bashkëpunimit përcaktohet me statut dhe rregullore komunale. Hulumtimi tregon se 19 Komuna të Kosovës ende nuk kanë bërë konsolidimin e Këshillave të Fshatrave (shih tabelën numër 5). Ndërsa 17 Komuna të tjera kanë të konsoliduara këto struktura dhe në uebfaqen e tyre ka informacione mbi to. Në proces të konsolidimit të tyre janë Komuna e Lipjanit dhe Rranillugut. Konsolidimi i

<sup>6</sup>Ligji NR. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, Neni 58

<sup>7</sup>Neni. 39.2 i ligjit për Vetëqeverisje lokale thotë që Anëtar i Kuvendit të Komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendëskryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës.



Tabela numër 5.

TË KONSOLIDUARA DHE KA INFORMATA	NUK JANË TË KONSOLIDUARA	JANË NË PROCES
Gjakova	Dragash	Lipjan
Ferizaj	Vushtrri	Rranillug
Graçanica	Prishtina	
Rahovec	Zubin Potok	
Mitrovicë e Jugut	Shtërpca	
Suhareka	Leposaviq	
Zveçan	Mitrovicë e Veriut	
Gjilan	Kamenica	
Drenas	Istog	
Partesh	Obiliq	
Klllokot	Shtime	
Viti	Podujeva	
Malisheva	Novobërda	
Prizren	Fushë Kosova	
Peja	Skenderaj	
Kaçanik	Mamusha	
Hani i Elezit	Klina	
	Deçan	
	Junik	





## Transparenca dhe llogaridhënia e Drejtorive Komunale

Shumica Komunave kanë arritur të krijojnë mekanizma që lehtësojnë komunikimin në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve Komunal, por edhe lehtësojnë qasjen në dokumente zyrtare. Ofrimi i linjave telefonike pa pagesë, digjitalizimi dokumenteve zyrtare (Open Data) dhe krijimi i instrumenteve (bazave të të dhënave) për regjistrimin dhe përcjelljen e statusit të kërkesave të qytetarëve, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut.

**Linjat telefonike pa pagesë** përmes së cilës qytetarët informohen apo paraqesin kërkesat e shqetësimit e tyre, janë të aplikueshme në 9 Komuna: Vushtri, Gjakovë, Rahovec, Mitrovica e Jugut, Prishtinë, Drenas, Obiliq, Prizren, Pejë.

**Ofrimi i një mekanizmi përcjellës** për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statusin e tyre, konsiderohet si një politikë e rëndësishme në adresimin e kërkesave të qytetarëve, por edhe për rritjen e nivelit të llogaridhënies. Përmes këtij mekanizmi, qytetarët kanë mundësi të përcjellin statusin e kërkesave të tyre, rrjedhimisht të informohen se në cilën fazë të trajtimit gjenden kërkesat dhe ankesat, të cilat ata kanë adresuar. Të dhënat e Transparometrit konfirmojnë se vetëm katër nga 38 Komuna të Kosovës, aplikojnë një sistem të tillë dhe atë; Komuna e Prishtinës, Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Mitrovicës së Veriut. Ndërsa, Komuna e Kamenicës është në proces të ndërtimit të një mekanizmi të ngjashëm.

**Përdorimi i rrjeteve sociale** - Qasja e lehtë në internet dhe përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale nga qytetarët, kanë bërë që shumë Komuna të shfrytëzojnë këto medime, për të plasuar informacione lidhur me aktivitetet e komunës dhe për të komunikuar me publikun. Të gjitha Komunat kanë faqe në Facebook dhe një numër të konsiderueshëm të ndjekësve, që mund të informohen në mënyrë të vazhueshëm për punën e komunës.

**Zyrtarët për informim** – Kontaktet për zyrtarët për informim janë të publikuara në 32 Komuna, katër Komuna të veriut nuk kanë të dhëna të publikuara për zyrtarët për informim. Ndërsa Komuna e Dragashi, Juniku nuk kanë fare zyrtar për informim.

KDI-ja gjatë realizimit të intervistave me zyrtarët për informim, përgjigjja për qasje në dokumente publike është bërë në kohën e paraparë me ligj. Ndërsa për tu shmangur numrit të madh të kërkesave të qytetarëve, për qasje në dokumente apo informacione publike, duhet të bëhet digjitalizimi i të dhënave publike, siç është shembulli i komunës e Prishtinës. Digjitalizimi i të dhënave dhe informacioni për publikun, i cili mundëson trajtim më të lehtë dhe më të shpejtë të kërkesave të qytetarëve, aplikohet në mënyrë të plotë vetëm në komunën e Prishtinës, ndërsa Komuna e Kamenicës është në proces të digjitalizimit të informacioneve publike.

Vendimet e kryetarit nuk janë të qasshme në të gjitha Komunat. Komuna e Graçanicës, Shtërpçës, Shtëmës, Novobërdës, Ranillug, Perteshit dhe Kllokotit nuk i ka të qasshme vendimet e kryetarit për publikun.

Ndërsa Komuna e Graçanica, Shtërpçë, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviç, Mitrovica e Veriut, Kamenica, Istog, Podujeve, Novobërd, Ranillug, Partesh, Kllokot, Fushë Kosovë, Malishevë, Mamushë, Deçan dhe Juniku nuk kanë të publikuar planin e punës së kryetarit për vitin 2019-të.

Vetëm Komuna e Klinës dhe Deçanit nuk kanë të publikuar borxhin Komunal. Ndërsa 20 Komuna nuk kanë të publikuar listen e pronave Komunale të dhëna me qira ose në shfrytëzim (shiko tabelën).

Shumica e Komunave kanë të publikuara konkurset dhe kriteret e punësimit, ndërkaq vetëm katër (4) Komuna siç janë: Komuna e Parteshit, Zubin Potokut, Junikut dhe Mitrovicës së Veriut nuk kanë të publikuara këto të dhëna.



## Rregullorja për ngacmime seksuale

Asnjë nga 38 Komunat e Kosovës nuk ka një rregullore për ngacmim seksual në vendin e punës. Pavarësisht që Komunat posedojnë kodin e etikës (kodi i etikës nuk e trajton ngacmimet seksuale), KDI-ja në vazhdimësi ka rekomanduar që Komunat të hartojnë rregulloren për ngacmime seksuale.<sup>8</sup> Duke ndërtuar një politikë të tillë, Komunat do të përcaktonin në mënyrë të qartë mekanizmat e brendshëm për raportimin dhe adresimin e rasteve të ngacmimeve seksuale në vendin e punës dhe me këtë do të kontribuonin në krijimin e një ambienti jodiskriminues, të barabartë dhe të sigurtë të punës.


## Emërtimet adekuate të dokumenteve publike në uebfaqet e Komunave

Gjatë publikimit të dokumenteve publike në uebfaqet e tyre, shumica e Komunave nuk kujdesen që aktet normative, vendimet dhe dokumentet zyrtare në përgjithësi të emërtohen në mënyrë adekuate dhe standardizuar. Për rrjedhojë, kjo krijon edhe vështirësi dhe humbje kohe në gjetjen e informacioneve të kërkuara. Sipas udhëzimit administrativ për transparencë në Komuna dhe atij për uebfaqet e institucioneve publike, dokumentet duhet të emërtohen në mënyrë adekuate dhe të standardizuar dhe të vendosen nëpër fushat përkatëse, në mënyrë që të mundësohet qasje e shpejtë dhe e lehtë në informacionin e kërkuar.

## Përdorimi i gjuhëve zyrtare

Sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve<sup>9</sup> të gjitha dokumentet zyrtare duhet të jenë të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare të Komunave. Mos respektimi i gjuhëve zyrtare, përveç që përbën shkelje ligjore të ligjit për përdorimin e gjuhëve zyrtare, pamundëson qasjen e qytetarëve të të gjitha etnive në dokumente publike dhe të dhënat e nevojshme rreth punës së komunës. Ligji për përdorimin e gjuhëve zyrtare nuk është duke u respektuar në mënyrë të plotë, nga shumica e Komunave të Kosovës.

A janë të gjitha dokumentet publike në të gjitha gjuhët zyrtare



<sup>8</sup> Shumica e komunave të Kosovës janë duke e hartuar Kodin e ri të Etikës, por kjo nuk do të thotë që pjesa e ngacmimeve seksuale do të trajtohet në këtë kod të etikës. Andaj edhe i bëhet thirrje që komunat të hartojnë një rregullore të veçantë për ngacmime seksuale.

<sup>9</sup> Ligji për përdorimin e gjuhëve. Shiko: <https://gzkr.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440> (Janar 2020).





### WEBFAQJA E KOMUNAVE NË GJUHËT ZYRTARE

PLOTËSISHT	PJESËRISHT	VETËM NJË GJUHË
Graçanica	Dragash	Zubin Potok
Shtërpca	Vushtrri	Zveçan
Kamenica	Gjakova	Leposaviq
Novobërda	Ferizaj	Mitrovicë e Veriut
Rranillug	Rahovec	Obiliq
Klllokot	Mitrovice e Jugut	Malisheva
	Prishtina	Deçan
	Suhareka	Kaçanik
	Gjilan	Hani I Elezit
	Drenas	
	Istog	
	Lipjan	
	Shtime	
	Podujevë	
	Partesh	
	Viti	
	Fushë Kosova	
	Skënderaj	
	Prizren	
	Mamusha	
	Klina	
	Peja	
	Junik	



Vetëm **9 KOMUNA** dhe kryesisht Komunat me shumicë serbe (**GRAÇANICA, PRISHTINA, PRISHTINA, SHËTËRËPCA, LEPOSAVIËI, KAMENICA, NOVOBËRDË, RRANILLUG DHE KLLOKOT**) kanë të përkthyer dokumentet si (vendimet, rregulloret, draft-rregulloret, thirrjet, procesverbalet) në gjitha gjuhët zyrtare, **23 KOMUNA** kanë pjesërisht të përkthyer, ndërsa **6 KOMUNA** nuk i kanë përkthyer dokumentet në të gjitha gjuhët zyrtare.

Në bazë të komunikimit me zyrtarët e zyrës për informim, theksohet që problemi i mos përkthimit të të gjitha dokumenteve zyrtare është evidente në shumicën e Komunave të Kosovës, pasi që Komunat përballen me numër të vogël të punonjësve administrativ që janë përgjegjës për çështjet e përkthimit.

Për më shumë, në bazë të monitorimit të **UEB FAQEVE TË KOMUNAVE** është konkluduar që web faqet e vetëm **6 KOMUNA** janë plotësisht të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare, **23 KOMUNA** janë pjesërisht të qasshme, ndërsa **9 KOMUNA** nuk kanë qasje në të gjitha gjuhët zyrtare.





# REKOMANDIMET

- **Materiali përcjellës për seancat e Kuvendeve Komunale:** Kuvendet Komunale duhet të fillojnë të praktikojnë, bashkangjiten e dokumenteve përcjellëse të nevojshme për diskutim me publikun, së bashku me thirrjen dhe rendin e ditës. Kjo do të ndihmonte, publikun, këshilltarët komunal që të jenë më mirë të informuar, për dokumentet që do të diskutohen.
- **Performanca e Kuvendeve Komunale:** Rekomandohet që Kuvendet Komunale të thërrasin në raportim kryetarin dhe drejtorët/et rreth çështjeve të caktura në interes të qytetarëve, kështu duke mundësuar rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve komunal përballë qytetarëve.
- **Konsolidimi i Këshillit të Fshatrave/ Bashkësive Lokale:** KDI-ja rekomandon që Kuvendet Komunale të bëjnë konsolidimin e Këshillave të fshatrave, të cilët mundësojnë komunikim më të lehtë në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.
- **Përdorimi i gjuhëve zyrtare:** KDI-ja rekomandon që ueb faqet e Komunave të jenë të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare, gjithashtu dokumentet publike të Komunave duhet të jenë të përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare, ashtu siç është e paraparë edhe me ligj. Po ashtu, KDI kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të ndihmojë komunat të rrisin kapacitetet e tyre njerëzore, me zyrtarë për përkthim të dokumenteve.
- **Mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve:** Rekomandohet që Kuvendet e Komunave të kenë mekanizmin përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve, fillimisht duke mundësuar sistemimin e kërkesave dhe ankesave, por gjithashtu edhe informimin sa më të mirë të qytetarëve rreth statusit të kërkesave dhe ankesave të tyre.
- **Emërtimi adekuat i dokumenteve të vecanta:** KDI-ja rekomandon që të bëhet emërtimi i dokumenteve në mënyrë të veçantë duke mundësuar qasjen më të lehtë dhe më të shpejtë tek dokumentet publike.
- **Mungesa e hapjes së të dhënave (Open Data) –** KDI-ja rekomandon që të bëhet hapja e të dhënave për publikun, kështu duke mundësuar trajtim më të lehtë të kërkesave të drejtuara ndaj tyre, që do të mund të ndikonte në uljen e volumit të punës së zyreve për informim, duke trajtuar më pak kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare.
- **Hartimi i rregullores për ngacmime seksuale:** Rekomandohet që Komunat të hartojnë rregullore e veçantë për adresimin e ngacmimeve seksuale brenda institucioneve publike.
- **Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike:** Niveli komunal duhet të gjejë mënyra më të mira, për të organizuar dhe njoftuar me kohë qytetarët për dëgjimet publike, përmes formave të drejtpërdrejta të komunikimit dhe rrjeteve sociale.
- **Për MAPL:** Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Administratës Publike, duhet të rrisin kapacitetet njerëzore dhe teknologjike në mënyrë që uebfaqet e komunave të funksionojnë pa pengesë dhe të ofrohet siguri nga sulmet kibernetike.





KDI-ja është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Projekti financohet nga:



British Embassy  
Pristina